

**Letër e hapur  
Kryetarit të Komunës së Drenasit z. Nexhat Demaku**

I nderuari z. Demaku,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin tuaj të mbajtur në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Realizimin e 240 projekteve kapitale gjatë mandatit 4 vjeçar;
- Detyrimin e Ferronikelit që të vendos filtrat;
- Ndërtimin e Parkut të Biznesit, ku do investojnë kompani të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare dhe ku do të punësohen rreth 600 njerëz;
- Ndërtimin e një qendre industriale të biznesit, në hapësirën përballë Parkut të Biznesit;
- Rregullimin e një impianti për ujëra të zeza që do të kushtoj rreth 200,000 euro;
- Lidhjen e fshatrave me infrastrukturë rrugore, kanalizim dhe ujësjellës;
- Investimin e mbi 2 milionë eurove në bashkëpunim me USAID-in dhe ujësjellësin "Prishtina", për furnizimin e të gjitha fshatrave me ujë të pijshëm;
- Ndërtimin e një shkolle të mesme e cila do t'i ketë 20 klasë dhe do të jetë e pajisur me laboratorë (deri në fund të vitit 2010);
- Rregullimin e kanalizimit në fshatin Korreticë e Ulët dhe rregullimin e shtratit të lumit Drenica (prioritete për vitin 2010),
- Ndërtimin e një punkti të shëndetësisë dhe asfaltimin e rrugës në fshatin Bytyç;
- Kanalizimin, ujësjellësin dhe ndërtimin e shkollës në fshatin Llapushnik;
- Asfaltimin e rrugës Llapushnik – Krajkovë;
- Ndërtimin e katër shkollave: në Drenas të Ri, Orllat, Gllobarë, dhe në lagjen e Feronikelit, të cilat do të jenë të gatshme në shtator të vitit 2010;
- Rregullimin e kanalizimit, ujësjellësit, dhe sistemit të energjisë elektrike në fshatin Sankoc, që në vitin e parë të mandatit;
- Rregullimin e kanalizimit dhe ujësjellësit në fshatin Fushticë;
- Ndërtimin e kanalizimit dhe ujësjellësit, dhe ndërtimin e një shkolle pesë klasëshe në fshatin Baic;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP  
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)